



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Data: 21.07.20 Ref.: 982/200

Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Nr. 05/L0031, datë 25.05.2016), nenit 7 dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ Nr.15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës, Udhëzimin Administrativ Nr. 02/2019, Nr. 08/2019 dhe Nr. 13/2019 për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ Nr. 15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës, Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 82-të, të mbajtur më 25.06.2020, mori:

V E N D I M

- I. Nuk akreditohet Kolegji Arbëri në nivel institucional.
- II. Ndalohet regjistrimi i studentëve të rinj për të gjitha programet e studimit me akreditim valid të kolegjit Arbëri për vitin akademik 2020 – 2021 deri në periudhën tjetër të riakreditimit institucional.
- III. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Arsyetimi

I. Kolegji Arbëri ka parashtruar kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA) për riakreditim institucional të cekur në dispozitivin I të këtij vendimi.

AKA ka organizuar vizitën me ekspertë ndërkombëtar të akreditimit në Kolegjin Arbëri më datë 22.05.2019 me qëllim të vlerësimit në nivelin institucional me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit më këtë përbërje: Yelena Istileulova, Elene Jibladze dhe Delia Gologan.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KShC) në mbledhjen e mbajtur më 25.06.2020 ka shqyrtuar aplikacionin e Kolegjit Arbëri dhe duke u bazuar në të gjeturat e ekspertëve ndërkombëtar të akreditimit gjatë realizimit të vizitës, dhe në rekomandimin përfundimtar të dhënë në raportin final të vlerësimit nga ekspertët e cekur më sipër, KSHC vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Në lidhje me riakreditimin institucional, raporti i ekspertëve ndërkombëtar të akreditimit, konstaton se Kolegji Arbëri nga gjithsej 11 kapituj të akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit i përmbush

standardet si vijon: i përmbush pjesërisht tetë (8) kapituj (Planifikimi strategjik; Planifikimi dhe menaxhimi financiar; Integriteti akademik; Mësimdhënia dhe të nxënit; Stafi, proceset e punësimit dhe zhvillimi profesional; Administrimi i studentëve dhe shërbimet mbështetëse; Burimet dhe hapësirat; Bashkëpunimi institucional), ndërsa nuk i përmbush tre (3) kapituj (Misioni publik dhe objektivat institucionale; Menaxhimi i cilësisë; Hulumtimi).

Kapitulli i parë (Misioni publik dhe objektivat institucionale / Nuk përmbushet): Sipas ekspertëve, Raporti i Vetëvlerësimit nuk referon drejtpërdrejt se kur është miratuar, rishikuar dhe diskutuar kjo deklaratë, dhe kush ishte i përfshirë në atë proces. Deklarata e misionit është shumë e përgjithshme, mjaft e gjatë dhe formale në 5 fjali, përmban fraza të përgjithësuara të cilat zakonisht nuk përdoren në mision. Prandaj, si e tillë deklarata e misionit nuk i plotëson kushtet e të qenit e shkurtër dhe e qartë. Sa i përket mësimdhënies, ekspertët nuk e shohin se si i referohet Kolegji Arbëri mësimdhënies për ti plotësuar kriteret.

Ekspertët nuk kanë mundur të gjejnë informata as për pjesëmarrjen e hisedarëve të brendshëm dhe të jashtëm në diskutimin e misionit, e pas kërkesës për dokumente shtesë, kolegji ofroi informacione jo formale dhe jo relevante për misionin. Përveç tjerash, ekspertët rekomandojnë që në mision duhet të përfshihen pjesë për vlerat e kolegjit Arbëri, të cilat mungojnë në RVV, dhe të shikohet se si janë ato të integruara në mision dhe objektivat institucionale. Rekomandim tjetër është edhe që Kolegji Arbëri duhet të vendos se deri në çfarë niveli dëshiron të jetë i përfshirë brenda UBT-së, dhe se statusi formal i kësaj marrëdhënie duhet të tregohet qartë, dhe nëse do të jetë i integruar në UBT, atëherë misioni, vizioni dhe vlerat e kolegjit Arbëri duhet të përshtaten ashtu që të reflektojnë prezencën e UBT-së në dokumentet e brendshme.

Kapitulli i dytë (Planifikimi strategjik, qeverisja dhe administrimi / Përmbushet pjesërisht): Ekspertët nuk kanë informacione të qarta lidhur me planin strategjik, së pari sepse dokumenti i dorëzuar është pa datë, nuk mund të kuptohet nëse është i vitit 2019 apo 2020, ka lëshime dhe disa mospërputhje brenda objektivave. RVV referon se plani strategjik deri në vitin 2023 është përgatitur nën udhëheqjen e drejtpërdrejt të presidentit me palët e interesit. Nga plani strategjik i kolegjit Arbëri, ekspertët vlerësojnë se ende është një draft dokument, i cili duhet të rishikohet, kompletohet dhe miratohet deri në një datë të caktuar. Vërehen pesë objektivat strategjike, të cilat janë të ndryshme nga objektivat e identifikuara në misionin publik në RVV, si dhe nuk është mjaft e qartë se si dhe kur është hartuar plani strategjik në konsultim me komunitetin akademik, palët e interesit nga industri të ndryshme, duke përfshirë edhe sektorin privat. Ekspertët rekomandojnë që plani strategjik të rishikohet duke marrë parasysh të gjitha dokumentet relevante, përfshirë buxhetin vjetor dhe atë afatgjatë, diskutimet brenda dhe jashtë kolegjit (me palët e interesit, përfshirë këtu edhe UBT). Gjithashtu rekomandojnë që të sigurohen indikacione të qarta të Kolegjit Arbëri si i pavarur nga Kolegji UBT, ose të sigurohen planet e qarta për integrimin, të dhëna të matshme dhe më shumë sqarime, si dhe të qartësohet se si do të bashkë-ekzistojnë këto dy kolegje në kornizën afatmesme dhe afatgjatë.

Kapitulli i tretë (Planifikimi dhe menaxhimi financiar / Përmbushet pjesërisht): Informacionet e ofruara për planifikimin financiar nga RVV kanë dallime të mëdha në shifra dhe duken shumë optimiste, dhe në bazë të llogaritjeve të ekspertëve del që ka mospërputhje mes numrit të planifikuar të studentëve dhe pagesës së studentëve për vitin akademik. Edhe pse kolegji përpiqet të përkrah studentët me nevoja të veçanta,

ekspertët nuk vërejnë ndonjë veprim konkret që do të shtynte këta studentë të studiojnë në kolegjin Arbëri.

Ekspertët rekomandojnë që kolegji Arbëri duhet të sigurojë prova të qarta ose analiza adekuate për parashikimin e rritjes së numrit të studentëve, pagesën, etj., duke u siguruar që ka burime të mjaftueshme për të realizuar objektivat, dhe të parashihet qëndrueshmëri e buxhetit vazhdimisht duke projektuar një buxhet tre vjeçar. Gjithashtu, institucioni duhet të ketë politikat e vlerësimit të rrezikut financiar dhe të sigurojë burime alternative të financimit. Planifikimi i buxhetit duhet të përfshijë përparësi në përputhje me objektivat strategjike të institucionit dhe të diskutohet me komunitetin akademik, kolegji duhet të mendojë për planifikimin e buxhetit në bashkëpunim me grupin UBT.

Kapitulli i katërt (Integriteti akademik / Përbushet pjesërisht): Sipas ekspertëve, kolegji e ka të miratuar kodin e etikës, i cili përcakton parimet kryesore të sjelljes etike dhe jep disa shembuj për secilin, por dokumenti kryesisht nuk i thekson ndryshimet se si këto parime mund të zbatohen në organet akademike, administrative apo studentore të kolegjit, si dhe nuk përmend parimet për plagjiaturë. Gjatë intervistave, është vërejtur se komuniteti akademik ka pak njohuri për kodin e etikës, por nuk dihet se a zbatohet në përputhshmëri me parimet e tij, e as studentët nuk kishin aq njohuri për ndonjë rregullore për plagjiaturë. Raporti i vetëvlerësimit nuk ofron informacione të sakta për Komisionin e Etikës, numrin e anëtarëve të tij, mënyrës së zgjedhjes së anëtarëve, kujt i propozon ndryshimet, si i mbledh provat të cilat shpijnë në ndryshime. Ekspertët rekomandojnë që zinxhiri i raportimeve të jetë i sqaruar mirë, të formalizohet dhe të bëhet transparent. Gjithashtu ekspertët kanë vërejtje që nuk ka të dhëna që kodi i etikës është duke u zbatuar në kolegji, sepse gjatë intervistave, përfaqësuesit e stafit akademik përmendën që ka pasur disa raste të sjelljes së keqe të studentëve, të cilat janë dërguar në Komisionin e Etikës, por nuk ka raporte ose vendime për rastet përkatëse. Vërejtje ka edhe për ueb faqen e kolegjit, në të cilën të interesuarit potencial nuk mund të bazohen në informata, sepse shumë informacione relevante mungojnë. Ekspertët theksojnë se pretendimi i menaxhmentit të Kolegjit Arbëri se institucioni tani është pjesë e ombrellës së UBT, kështu që shumica e rregullave, rregulloreve dhe informacioneve të tjera kyçe "ndahen" nga kolegji, konsiderohet si jo relevante, sepse Kolegji Arbëri është një entitet juridikisht i pavarur.

Kapitulli i pestë (Menaxhimi i cilësisë / Nuk përbushet): Kolegji pretendon se përpiqet të krijojë një kulturë të cilësisë, por në Raport të Vetëvlerësimit nuk ka dokumente për sigurimin e cilësisë. Për këtë çështje, përfaqësuesit e kolegjit thonë se fokusi i tyre kryesorë për dy vitet e fundit ishte të harmonizonin rregulloret e tyre me ato të Kolegjit UBT, gjë e cila ishte e vështirë e identifikueshme. Gjatë intervistave, menaxhmenti i kolegjit dhe përfaqësuesit e sigurimit të cilësisë sqaruan se bashkëpunimi me familjen më të madhe UBT sapo ka filluar, duke justifikuar kështu mungesën e provave. Ekspertët janë skeptik që kolegji është në rrugën e duhur për të realizuar këto plane, pasi zyrtarisht, ajo u bashkua me UBT në 2018, kështu që do të kishte kohë të mjaftueshme për të grumbulluar disa prova në lidhje me sigurimin e cilësisë në mësim apo fusha të tjera, të cilat do të korrespondonin me deklaratat e tyre të guximshme për harmonizimin.

Kapitulli i gjashtë (Mësimdhënia dhe të nxënit / Përbushet pjesërisht): Në Raport të Vetëvlerësimit përmendet që kolegji e ka të miratuar Rregulloren për studimet Bachelor dhe Master, por ekspertëve nuk u janë ofruar dokumente të tilla për ti vlerësuar. Për më tepër, ato nuk mund të gjenden as në ueb faqen

e Kolegjit. Megjithëse përshkrimi në RVV dhe ai i ofruar gjatë diskutimit në internet është i vlefshëm, institucioni duhet të ketë një dokument të miratuar zyrtarisht. Nëse kolegji tashmë i ka ato, siç u përmend, ata duhet t'i vënë ato në dispozicion për publikun. Në statutin e kolegjit ka disa informacione për programet e studimit, e sipas ekspertëve kriteret për të zhvilluar dhe vlerësuar programet janë të përgjithshme dhe madje të paqarta, prandaj ekspertët rekomandojnë që kolegji të zhvillojë më tej këto rregullore, në mënyrë që të gjitha detajet e zhvillimit, zbatimit dhe vlerësimit të programit të studimit të përshkruhen aty. Procedurat përkatëse gjithashtu duhet të elaborohen, në mënyrë që të sigurohet zbatim i përshtatshëm i parimeve të përcaktuara në rregulloret e lartpërmendura. Hapi tjetër, do të ishte që kolegji të monitorojë zbatimin e këtyre rregulloreve. Sa i përket emërimit të gradave të diplomave, kolegji duhet të përpiket më shumë për të identifikuar, cila është mënyra më e saktë dhe më profesionale e strukturimit dhe më pas emërimit të diplomave të programeve të tyre. Ekspertët e patën të pamundur edhe të gjejnë informacione të sakta lidhur me planprogramet e kurseve, programet mësimore, orarin e mësimit, sepse dokumentet e ofruara ishin jo të plota dhe pa emërtime. Kjo çon në përfundim se mësimdhënia nuk është e organizuar mirë, as në letër e as në realitet.

Kapitulli i shtatë (Hulumtimi / Nuk përmbushet): Ekspertët e akreditimit kanë vërejtur se në planin financiar të institucionit, Kolegji Arbëri ka projektuar një rritje të konsiderueshme të resurseve të dedikuara për komponentin e hulumtimit. Mirëpo, në mungesë të një shpjegimi të detajuar se çfarë aktivitete do të mbulohen nga këto fonde, resurset e ndara sipas viteve mbesin abstrakte. Në raportin e vetëvlerësimit, kapacitetet kërkimore të UBT-së janë prezantuar si kapacitete të Kolegjit Arbëri. Për ekipin e ekspertëve ky nuk mund të konsiderohet si informacion i saktë, pasi që kolegji Arbëri është entitet i pavarur dhe duhet të vlerësohet në bazë të kapaciteteve të veta. Pas kësaj ekspertët kanë vënë në pah faktin se Kolegji Arbëri ka prezantuar një dokument që quhet plan i hulumtimit, ku nuk është treguar se kur është zhvilluar dokumenti. Për më tepër, ekspertët kanë konstatuar se ky plan është më shumë një dokument informativ, që tregon se si kapacitetet hulumtuese të UBT-së mund të jenë të dobishme për kolegjin Arbëri, por nuk mund të jetë plan hulumtimi për institucionin, pasi që nuk përmban afate kohore, mundësi për alokim të resurseve dhe elemente tjera që duhet të përfshijë një plan çfarë mëton të jetë dokumenti i prezantuar. Si përfundim, në këtë kapitull të standardeve ekipi i ekspertëve rekomandon që kolegji Arbëri duhet të zhvillojë një dokument realist dhe gjithëpërfshirës për komponentin e hulumtimit, për të orientuar punën e institucionit në këtë fushë. Prioritetet duhet të identifikohen qartë dhe resurset të ndahen në mënyrë specifike. Progresi eventual duhet të monitorohet dhe krahas kësaj duhet të zhvillohet sistemi për mbështetje të stafit akademik.

Kapitulli i tetë (Stafi, proceset e punësimit dhe zhvillimi profesional / Përmbushet pjesërisht): Ekspertët kanë theksuar se kolegji Arbëri nuk ka një Manual të Punësimit, ku përveç përgjegjësive dhe detyrave (rregulloreve të brendshme) do të përfshiheshin informata edhe për rekrutimin, mbikëqyrjen, vlerësimin e performancës, përkrahjen që ofrohet në formë të zhvillimit profesional etj. Për më tepër, ekspertët kanë potencuar se në raportin e vetëvlerësimit nuk është specifikuar proporcioni në mes të studentëve dhe profesorëve me orar të plotë, por vetëm thuhet se ky proporcion është i arsyeshëm dhe i sigurt. Në fund, sa i përket këtij kapitulli të standardeve, ekspertët rekomandojnë se Kolegji Arbëri duhet të përfshijë të gjitha versionet finale të dokumenteve dhe rregulloreve të miratuar në uebfaqe duke i bërë ato të qasshme për publikun.


Kapitulli i nëntë (Administrimi i studentëve dhe shërbimet mbështetëse / Përmbushet pjesërisht): ekipi i ekspertëve të akreditimit kanë rekomanduar në raportin vlerësues se kolegji Arbëri duhet të publikojë në uebfaqe kriteret dhe kërkesat për pranim të studentëve. Në këtë kontekst, ekspertët kanë vërejtur se kolegji Arbëri nuk ka një uebfaqe të vetën por në uebfaqen e UBT Group është një seksion i dedikuar për kolegjin Arbëri. Ekspertët rekomandojnë që kolegji të zhvillojë një faqe të vetën të internetit ku do të prezantonte informata lidhur me programet që ofron, shërbimet, bursat, pagesat për studentë, etj. Në kuadër të këtij kapitulli të standardeve ekspertët gjithashtu kanë potencuar se sipas informatave të dhëna, Kolegji Arbëri posedon një zyre për karrierë, mirëpo në takimin me studentë është kuptuar se ata asnjëherë nuk i kanë shfrytëzuar shërbimet e kësaj zyre.

Kapitulli i dhjetë (Burimet dhe hapësirat / Përmbushet pjesërisht): ekspertët kanë konstatuar se megjithëse në raportin e vetëvlerësimit potencohet se biblioteka dhe hapësirat përcjellëse vlerësohen në baza vjetore në përputhje me Planin për Zhvillim të Bibliotekës, një plan i tillë nuk i është prezantuar asnjëherë ekspertëve. Përveç kësaj, megjithëse Kolegji Arbëri ofron qasje në databaza elektronike si rezultat i bashkëpunimit me UBT Group, gatë takimeve me stafin akademik dhe me studentët, ekspertët e akreditimit kanë kuptuar se kjo mundësi nuk shfrytëzohet. Ekipi i ekspertëve rekomadon që kolegji të intensifikojë përpjekjet për të inkurajuar komunitetin akademik të shfrytëzojë këto burime, si dhe të zhvillojë procedura për të monitoruar shpeshësinë e shfrytëzimit të tyre.

Kapitulli i njëmbëdhjetë (Bashkëpunimi institucional / Përmbushet pjesërisht): ekspertët kanë konstatuar se kolegji Arbëri nuk ka të emëruar një person nga menaxhmenti i cili do të ushtronte përgjegjësitë dhe detyrat që kanë të bëjnë me këtë fushë. Ekipi i ekspertëve të akreditimit, në raportin e vlerësimit shton se kjo fushë e përgjegjësie duket të jetë e ndarë në mes të presidentit të kolegjit, dekanit dhe personit përgjegjës për sigurim të cilësisë. Në këtë kontekst ekspertët rekomandojnë se caktimi i këtyre përgjegjësieve një zyrtari të lartë të menaxhmentit do të ndihmonte kolegjin që më lehtë të monitorojë përmbushjen e objektivave të caktuara në këtë fushë. Sa i përket marrëveshjeve të bashkëpunimit, ekspertët kanë deklaruar se kolegji Arbëri ka prezantuar 33 sosh, mirëpo ka shumë pakë informata lidhur me atë se çfarë lloje të projekteve janë zbatuar në kuadër të këtyre marrëveshjeve dhe cili është roli i kolegjit në hartimin dhe zbatimin e tyre.

Në kuadër të këtij kapitulli të standardeve ekspertët kanë konstatuar se sa i përket organizimit të aktiviteteve ndërkombëtare, kolegji Arbëri duhet të fokusohet në temat apo fushat kërkimore që janë me interes për komunitetin akademik të kolegjit, dhe se angazhimi në organizime me karakter ndërkombëtar dhe kontributi në komunitet duhet të jenë pjesë e kriterëve për vlerësim dhe avancim të stafit. Krejt në fund të këtij kapitulli, ekspertët konsiderojnë se është tejet e rëndësishme që kolegji Arbëri të qartësojë marrëdhëniet me Grupin UBT dhe ndarjen e të drejtave dhe përgjegjësieve përkitazi me përpjekjet për internacionalizim të kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesë sipas Nenit 125 dhe 126 të Ligjit mbi Procedurën e Përgjithshme Administrative (Nr. 05/L-031, datë 25 Maj 2016). Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet organit të Komisionit të Ankesave të AKA-së, sipas Rregullores nr. 2/2019, në afatin prej 30 ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ sipas Nenit 127 të LPPA.


Prof. Dr. Gazmeja Luboteni
Kryetar i Këshillit Sekretëror të Cilësisë



Vendimi iu dërgohet:

- Kolegjit Arbëri
- MASH;
- Arkivit të AKA-së.